



# QENDRA PËR SHËRBIME STUDENTORE DHE KARRIERË

## Takim i të rinjëve european në Kamenka , Republika Çeke

Iniciativa social-kulturore “Culture Goes Europe”, organizon “**Takimin e të rinjëve european**” në Kamenka, Republika Çeke. Takimi do të zhvillohet prej datës 22- 25 gusht, 2010.

Takimi është i hapur për të gjithë të rinjtë të cilët janë të interesuar të krijojnë miqësi të reja me bashkëmoshatarë nga shtete të ndryshme të Europës, që të zhvillojnë aftësitë e tyre nëpërmjet aktivitetit të organizuar në takim, edhe atë nëpërmjet “**Shërbimit Vullnetar European**”, aktivitet ky ku të rinjtë pjesëmarrës do të kenë mundësinë që të përfitojnë përvojë të re, si dhe të kuptojnë mirë shërbimin e ashtuquajtur “**Shërbim Vullnetar European**”.

### Shpenzimet

Pagesa për participim është: **15 euro**, në të cilën shumë përfshihen akomodimi dhe ushqimi.

### Si të aplikoni?

Aplikimi realizohet duke dërguar një email deri te: [office@cge-erfurt.org](mailto:office@cge-erfurt.org), ku do të orientoheni për informata më të detajuara. Organizatorët do të ju dërgojnë dokumentet e nevojshme që duhet për të aplikuar, si dhe formularin për aplikim.

### Afati i fundit për aplikim është: 12 korrik, 2010

Për më shumë informacion vizitoni webfaqen : <http://www.cge-erfurt.org/site/nachrichten.htm>